



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0569**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare dhe Isa Hasani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Flamur Isufi B.I., kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit të MINISTRIA E SHËNDETËSISË në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pajisje për laboratorët mikrobiologjik në IKSHPK” me numër të prokurimit 206-23-651-1-1-1, me 13/12/2023, mori:

## **Vendim**

1. Përfundon procesi i shqyrtimit administrativ i filluar sipas ankesës së OE “Flamur Isufi” B.I. , e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 11.08.2023 (me numër protokollit 2023/0569) për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me pajisje për laboratorët mikrobiologjik në IKSHPK Lot 2” me nr. të prokurimit:206-23-651-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Shendetesise.
2. Ankuesi lidhur me këto veprime të AK rreth anulimit aktivitetit të prokurimit në kundërshtim me ligjin, mund të drejtohet Gjykatës kompetente për mbrojtjen e të drejtave të tij/saj.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “Flamur Isufi” B.I.

## **Arsyetim**

*- Faktet dhe rrethanat procedurale –*

Me 15.02.2023, Ministria e Shendetesise. , në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me pajisje për laboratorët mikrobiologjik në IKSHPK Lot 2” me nr. të prokurimit: 206-23-651-1-1-1 Nderkaq me datën 16.05.2023 është publikuar njoftimi mbi vendimin e AK. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës: Furnizime, vlera e parashikuar e kontratës për Lot 2: 165,600.00 € . Hapja e ofertave për këtë aktivitet të prokurimit është bërë me datë 12.04.2022. Pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit që kanë dorëzuar ofertë kanë qenë katër (4) OE, dhe

AK më datë 16.05.2022, publikon njoftimin mbi vendimin e AK (B58) duke e shpallur fitues OE Flamur Isufi B.I. në vlerë prej 165,180.00€.

Pas kalimit të afatit ligjor për parashtrim të kërkesave për ri-shqyrtim/ankesave konform afateve ligjore të përcaktuara në LPP gjegjësisht nenit 108/A, autoriteti kontraktues më datë 24.05.2022, duke mos pasur asnjë kërkesë për ri-shqyrtim/ankesë në OSHP, bënë edhe publikimin njoftimit për dhënie të kontratës (B08). Pas publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës, AK nuk ndërmerr asnjë veprim për dy (2) muaj, ku më datë 27.07.2023 publikon njoftim për anulim të aktivitetit të prokurimit (B10), duke e përfunduar procedurën e prokurimit me arsyetimin "Anulimi i Dhënies se kontratës per LOT 2 bëhet me kërkesën e Sekretarit te Përgjithshem me Nr. protokollit 05-4516 te datës 24.07.2023, me te cilën ZKA e ka njoftuar ZPP te Divizionit te Prokurimit qe Andaj nga ana juaj kërkoj që të procedoni në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik në anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit . Sekretari i Përgjithshem ka refuar ta nënshkruaj kontratën dhe ka kërkuar qe kontrata te anulohet, me arsyetimin se specifikat teknike janë hartuar ne mënyrë qe kanë favorizuar prodhues specifik, duke e kufizuar konkurrencen. Bazuar ne opinionin e KRPP-së, ZKA ka kërkuar ekspertizë nga njësia e Bankës Botërore, me çka bazuar ne opinionin e tyre është arritur ne përfundimin e këtij aktiviteti".

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues“Flamur Isufi” B.I. me datën 11.08.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 569/23, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

#### ***- Vlerësimi dhe administrimi i provave –***

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkritazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 17.08.2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE “Flamur Isufi” B.I.

I. Aprovohet, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik“Flamur Isufi” B.I. , e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 11.08.2023 (me numër protokollit 569/23) për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me pajisje per laboratorët mikrobiologjik ne IKSHPK Lot 2” me nr. të prokurimit:206-23-651-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Shendetesise.

II.Të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

*Pohimet ankimore të ankuesit*

Ankuesi pretendon se anulimi i dhënies se kontratës për LOT 2 është i pa bazuar dhe nuk qëndron për faktin se ne jemi shpallur si tenderues të sukseshëm, pasi që i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, fakt ky i vërtetuar nga vet AK, pasi që e njëjta na ka dërguar edhe draft-kontratën për këtë lot. Përderisa është nënshkruar fillimisht

raporti i vlerësimit nga komisioni vlerësues dhe nga ana e zyrtarit përgjegjës të prokurimit, është publikuar njoftimi mbi vendimin dhe janë kaluar të gjitha çështjet procedurale të drejtës së ankesës dhe përderisa është publikuar njoftimi për dhënie të kontratës, kuptohet qartë se janë përmbushur të gjitha kushtet për nënshkrim të kontratës sipas nenit 26 të LPP. Refuzimi i ZKA për të nënshkruar kontratën është ndërhyrje direkte në proces të prokurimit dhe për më tepër ky veprim shpërfaq tendencë diskriminuese ndaj neve dhe favorizuese për ndonjë kompani të caktuar. andaj ky veprim është kundërligjor nga AK.

Eksperti shqyrtues i caktuar për trajtimin e këtyre pretendimeve ka bërë konstatimin e tij duke u thirrur në dispozita ligjore si: *LPP Nr. 04-L- 042 & 05-L-068 & 05-L-092 - Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës 3. Me kërkesën me shkrim nga cilado pale e interes, autoriteti kontraktues i siguron qasje të arsyeshme pales që kërkon të ketë qasje në të dhënat e përshkruara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, përveç informata secrete afariste të cilat vërtetohen sit ë tilla nga një autoritet përkatës që kanë të bëjnë me çfarëdo aktiviteti të prokurimit që është mbyllur. Për qëllime të paragrafit 3. të këtij neni, aktiviteti i prokurimit konsiderohet i mbyllur (i) në datën e publikimit të njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit, (ii) në datën e dhënies së kontratës në rast të tenderëve sipas nenit 37 të këtij ligji, ose (iii) nëse aktiviteti i prokurimit formalisht është anuluar ose përndryshe është përfunduar para dhënies ose zgjedhjes së fituesit, atëherë në datën e njoftimit për anulim sipas paragrafit 2. të nenit 62 të këtij ligji ose në datën kur aktivitetet ishin përmbyllur.*

*Rregullore Nr.001\_2022 për prokurimin publik - Neni 43 Ndërprerja e procedurave të prokurimit 43.5 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme: a. asnjë tender nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar; b. asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm; RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK 81 c. numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE është më pak se 3(tre); d. nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar; e. numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/ konkurruese me negociata është më pak se 3; f. nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar; g. asnjë nga projektet e pranuar në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm; h. nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit; i. një shkelle e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi; j. nëse AK gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes se procedures ka përdorur gabimisht opcionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i pariparueshëm; ose k. nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP.*

*Bazuar ne Rregullore Nr.001\_2022 për prokurimin publik - Neni 43 Ndërprerja e procedurave të prokurimit, asnje kusht nuk eshte plotesuar qe AK te merr vendim per anulimin e aktivitetit te prokurimit dhe si i tille duhet te vazhdoje sepse ne kete faze "para nenshkrimit te kontrates- OE ankues - i rekomanduar per kontrate" kur dihet i gjithë informacioni nga OE te cilet kane ofertuar si nga aspekti i çmimeve, ashtu edhe nga natyra e pershkrimit te punimeve mendoje se nuk ka baze per te anuluar dhe si i tille duhet te vazhdoje procedura. Tutje eksperti shqyrtues ka vazhduar se, anulimi i dhënies së kontratës për Lotin 2 nga Sekretari i Përgjithshëm duke mos nënshkruar kontratën dhe duke ndërhyrë në kompetencat e menaxherit të prokurimit është një veprim që mund të shoqërohet me sfida dhe pasojë juridike, pasi kompetencat e menaxherit të*

prokurimit janë të përcaktuara dhe të kufizuara nga procedurat e prokurimit publik dhe ligji i zbatueshëm. Menaxheri i prokurimit ka përgjegjësi për të zbatuar procedurat e prokurimit publik në përputhje me ligjin dhe parimet e prokurimit. Në këtë kontekst, Sekretari i Përgjithshëm nuk duhet të ndërhyjë në mënyrë arbitrare ose të paligjshme në kompetencat e menaxherit të prokurimit. Bazuar në informacionin e dhënë, eksperti shqyrtues propozon që panelit shqyrtues të aprovohet ankesën e (OE) si e bazuar. Pra, rekomandimi është që njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit të anulohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Kjo do të thotë që paneli shqyrtues duhet të konsiderojë se ankesa e OE ka një bazë për të e aprovuar si të tillë dhe se njoftimi për anulim nuk është i bazuar në të dhëna të mjaftueshme.

#### *Gjetjet e Panelit Shqyrtues -*

Paneli shqyrtues vlerëson se raporti i ekspertizës i përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit.

Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/saj, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, Paneli shqyrtues ka administruar si prova: Raportin e Ekspertit Shqyrtues, ankesën e OE Flamur Isufi B.I., Njoftimin mbi vendimin e AK (B58), Njoftimin për Dhënie (B08), Njoftim për anulimin e aktivitetit të prokurimit nr. 214-23-2530-2-1-1.

Paneli Shqyrtues lidhur me Njoftimin e Autoriteti Kontraktues, datës, 27.07.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit nr. 206-23-651-1-1-1, vëren se AK në faqen tre(3) të Njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit, në nenin IV.4 Arsyeja e anulimit të procedurës së prokurimit publik, ka shënuar këto pika mbi të cilat bëhet anulimi i këtij aktiviteti "Një urdhër i lëshuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit kërkon anulimin e njoftimit për dhënie të kontratës. Vendimi i Organit Shqyrtues të Prokurimit; Anulim dhe Ri-tenderim i aktivitetit të prokurimit; Një rekomandim i lëshuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik kërkon anulimin e njoftimit për dhënie të kontratës" dhe tek informacionet shtesë deklaron se "Anulimi i Dhënies së kontratës për LOT 2 bëhet me kërkesën e Sekretarit të Përgjithshëm me Nr. protokollin 05-4516 të datës 24.07.2023, me të cilën ZKA e ka njoftuar ZPP të Divizionit të Prokurimit që Andaj nga ana juaj kërkohet që të procedoni në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik në anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit . Sekretari i Përgjithshëm ka refuzuar ta nënshkruaj kontratën dhe ka kërkuar që kontrata të anulohet, me arsyetimin se specifikat teknike janë hartuar në mënyrë që kanë favorizuar prodhuesin specifik, duke e kufizuar konkurrencën. Bazuar në opinionin e KRPP-së, ZKA ka kërkuar ekspertizë nga njësi e Bankës Botërore, me çka bazuar në opinionin e tyre është arritur në përfundimin e këtij aktiviteti".

Paneli shqyrtues ka evidentuar dispozitat ligjore për prokurim publik që kanë ndërlidhje me këto veprime të AK. Pasi që neni 62 i LPP mjaftë qartë precizon se në cilat raste mund të përfundojë aktiviteti i prokurimit, po ashtu edhe në nenin 43 të RRPP 001/2022 përcaktohen rastet se kur mund të bëhet ndërprerja e procedurës së prokurimit, ndërsa, arsyeshmëria e AK për ndërprerje të kësaj procedure nuk parashihet në këtë dispozitë. Sepse AK është i obliguar të që konform dispozitave ligjore ta bëjë ligjshmërinë e secilit veprim dhe këto të verifikohen para inicimit të

aktivitetit të prokurimit por edhe në fazat e më të vonshme. Ndërsa, jo në fazën kur publikohet njoftimi për dhënie të kontratës (B08) kur pritet të bëhet edhe nënshkrimi i kontratës nga palët. Edhe interpretimi i KRPP ashtu siç është e cekur në të përgjigjja ndërlidhet me tërë procesin e prokurimit publik që nga inicimi i aktivitetit të prokurimit e deri në mbylljen e tij. Ndërsa, me publikimin e njoftimit për dhënie të kontratës nga ana e AK, aktiviteti i prokurimit konsiderohet i mbyllur sepse kalon edhe koha për ankesë në AK dhe OSHP, dhe këto veprime të AK janë pas mbylljes së aktivitetit të prokurimit.

Me publikimin e njoftimit mbi vendimin e AK (B58) dhe skadimin e afateve kohore për parashtrim të ankesave, pastaj me publikimin e njoftimit për dhënie të kontratës (B08) për panelin shqyrtues konform dispozitave ligjore konsiderohet aktiviteti i mbyllur, ashtu siç e përcakton edhe neni 10 paragrafi 3, pika (i) i LPP, citat "aktiviteti i prokurimit konsiderohet i mbyllur (i) në datën e publikimit të njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit", si dhe nenin 42.4 të RRPP nr.001/2022.

Në nenin 42.4 i RRPP nr. 001/2022, e obligon AK që, citat: "*Pas skadimit të afatit kohor për parashtrim dhe shqyrtim të ankesave në Njoftimin mbi Vendimin e AK(B58), Autoriteti Kontraktues obligohet të përgatit draftin e kontratës dhe nënshkruaj ate brenda 30 ditëve kalendarike*", ashtu sikurse e obligon edhe neni 24, paragrafi 2 i LPP "*Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj*".

Andaj, paneli shqyrtues bazuar ne nenin 10 te LPP, lidhur me nenin 42.4 i RRPP nr. 001/2022, vlerëson se kjo çështje është përfunduar dhe rrjedhimisht vendosi si në pikën 1 të dispozitivit.

Kurse ankuesi për realizimi e të drejtës së tij/saj mund ti drejtohet institucioneve kompetente.

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizozi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se shqyrtimi i kësaj ankesë bie jashtë autorizimeve të përcaktuara ligjore.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues  
**Vedat Poterqoi**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - Flamur Isufi B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: